



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më ____ . ____ . 2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

Data 16/06/2025

Drejtuar : Operatorit Ekonomik (OE) “**ELBA OIL 2015**” sha, me NIPT L52606201T, me adresë qendrore sipas QKB : ELBASAN Xibrake Labinot fushe, Kantjeri midis fshatrave Mirake-Xibrake, Zona Kadastrale nr 3864,pasuria me nr 734/1.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen të dhënat :

Tipi i Kontratës : Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit : : “E hapur e thjeshtuar”.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit : REF-46732-05-02-2025

- Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje filtra,vaj motorri, hidraulike, antifrizë, alkool frenash viti 2025” për nevoja të NSHP-së ”**, me fond limit **1.664.640** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dyzetë) **lekë pa TVSH.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE : 05.05.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : Nr. 24 Date 12.05.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik (OE) “EXIMOIL” sha,

NIPT K91715006E

Vlera :976.410 (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori Ekonomik (OE) “O-SPAlbania” shpk,

NIPT M11424016S

Vlera : 1.213.909,70 (një milion e dyqind e trembëdhjetëmijë e nëntëqind e nëntë presje shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori Ekonomik (OE) “ELBA OIL 2015” sha,

NIPT L52606201T

Vlera : **1.431.750 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori Ekonomik (OE) “Sorgiena Agaj”, P.F

NIPT M31316031U

Vlera : **1.518.900 (një milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH**
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori Ekonomik (OE) “BREGU COMPANY”, shpk,

NIPT L82729403H

Vlera : **1.595.000 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1 - O.E. “EXIMOIL” sha me NUIS K91715006E skualifikohet për arsyen se, pasi KVO ka zbatuar formulën për të verifikuar ofertat nëse janë apo jo anomalisht të ulëta sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, ka rezultuar se oferta e “EXIMOIL” sha me vlerë **976 410** lekë pa TVSH, rezulton të jetë anomalisht e ulët, pasi zbritja e mundshme (85% e mesatares së ofertave të vlefshme), është në vlerën **1 145 114.85 lekë.**

Duke qënë se kjo procedurë prokurimi publik është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pra nën kufirin e lartë monetar, duke qënë në kushtet e pikës 5 të nenit 93 të LPP-së i ndryshuar, dhe në kushtet e pikës 4, të nenit 82, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, i cili përcakton se “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen

si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.”, duke qënë se oferta e OE “EXIMOIL” sha vlerësohet si anomalisht e ulët nga zbatimi i formulës, atëherë kjo ofertë refuzohet dhe skualifikohet nga procedura pa i kërkuar sqarime OE “EXIMOIL” sha.

2. OE “O-SP Albania” shpk, ka mungesat dhe parregullsit si më poshtë :

O.E. “O-SP Albania” sha në dokumentacionin fizik të dorëzuar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër, nuk ka paraqitur dokumentin fizik zyrtar për Operatorin Ekonomik, siç kërkohet në shkronjën **“b”**, të nenit 26/2 mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre.

Në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, **“b”**, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*.

Ndërkohë, në shkronjën **“b”**, pikën 2 të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet se *“**operatori ekonomik** nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së.”*.

Bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, O.E. “O-SP Albania” sha ka pasur detyrimin të paraqesë dhe dorëzojë fizikisht tek AK Bashkia Mallakastër dëshminë e penalitetit të personit juridik “O-SP Albania” sha me NUIS M11424016S për të vërtetuar sipas shkronjës **“b”**, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, se *“**operatori ekonomik** nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së.”*. Referuar inventarit fizik dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga O.E. “O-SP Albania” sha, rezulton se ky OE ka dorëzuar vetëm 1 (një) dokument Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), fletë 1 (një), nr.kërkese 15, datë 03.06.2025, vetëm për administrator/aksioner z.A.M, dhe nuk ka dorëzuar Vërtetim të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për personin juridik ofertues O.E. “O-SP Albania” sha.

Në kushtet që O.E. “O-SP Albania” sha, referuar dokumentacionit fizik të inventarizuar dhe të protokolluar në autoritetin kontraktor Bashkia Mallakastër me nr.2035/7 prot., datë 04.06.2025, nuk ka dorëzuar dokumentin fizik sipas bazës ligjore të sipërcituar, atëherë ky OE nuk përmbush kriterin e përcaktuar në shkronjën **“b”**, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, dhe për këtë arsye O.E. “O-SP Albania” sha skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik (OE) **“ELBA OIL 2015” sha** me NIPT L52606201T, me adresë qendrore sipas QKB : ELBASAN Xibrake Labinot fushe, Kantjeri midis fshatrave Mirake-Xibrake, Zona Kadastrale nr 3864, pasuria me nr. 734/1 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1.431.750 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj

(me urdhër për delegim kompetence)

ZV/KRYETARI

Guri Nuhaj